



REPUBLIKA E KOSOVËS
ZYRA E AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM

Nr. i Dokumentit: 22.14.1-2012-08

RAPORTI I AUDITIMIT
PËR PASQYRAT FINANCIARE TË KOMUNËS SË PRIZRENIT
PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2012

Prishtinë, Qershor 2013

Zyra e Auditorit të Përgjithshëm (ZAP) kryen auditime të rregullsisë si dhe ato të performancës. Auditori i Përgjithshëm, Lage Olofsson, është kreu i ZAP-it që ka të punësuar rreth 140 anëtarë të stafit. Auditori i Përgjithshëm dhe ZAP janë të pavarur dhe që certifikon rreth 90 Pasqyra Vjetore Financiare për çdo vit, derisa ndërmarrin forma të tjera të auditimit.

Misioni ynë është që të kontribuojmë në menaxhim të shëndoshë financiar në administratë publike. Ne do të kryejmë auditime cilësore në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit të sektorit publik dhe praktikat e mira evropiane. Ne do të ndërtojmë besim në shpenzimin e fondeve publike. Ne do të luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe palëve tjerë të interesit në rritjen e llogaridhënies publike.

Raportet e nxjerra nga ZAP në mënyrë direkte promovojnë llogaridhënien pasi që ato ofrojnë bazë për ti mbajtur llogaridhënës menaxherët e organizatave individuale buxhetore.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur për opinionin e auditimit dhe raportin mbi Pasqyrat Vjetore Financiare të Komunës së Prizrenit në konsultim me Ndhmës Auditorin e Përgjithshëm, Qerkin Morina, i cili ka bërë mbikëqyrjen e auditimit.

Opinionin dhe raportin i nxjerrë janë rezultat i auditimit të kryer nën menaxhimin e Drejtorit të Auditimit, Florim Beqiri mbështetur nga Lavdim Maxhuni (Udhëheqës i ekipit), Faik Thaqi, Evetar Zeqiri dhe Shpresa Zenelaj.

TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme.....	4
1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit.....	7
2 Pasqyrat vjetore financiare.....	8
3 Rekomandimet e vitit paraprak	10
4 Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli	12
5 Sistemi i auditimit të brendshëm	27
6 Konkluzioni i përgjithshëm	29
Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinionëve të aplikuara nga ZAP	30
Shtojca II: Rekomandimet e vitit paraprak.....	32

Përmbledhje e përgjithshme

Hyrje

Ky raport përmbledh çështjet kryesore që dalin nga auditimi ynë i Pasqyrave Vjetore Financiare (PVF-të) për vitin 2012 për Komunën e Prizrenit. Dëshiroj të falënderoj Kryetarin e Komunës dhe stafin e tij për ndihmën e tyre gjatë procesit të auditimit.

Auditimi i PVF për vitin 2012 ishte ndërmarrë në përputhje me Standardet e njohura Ndërkombëtare të Auditimit të Sektorit Publik (SNISA) të nxjerra nga INTOSAI. Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat për të cilat ne menduam se ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me PVF.

Auditimi ynë është fokusuar në:

- PVF;
- Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin e Brendshëm (duke përfshirë menaxhimin dhe ekzekutimin e buxhetit); dhe
- Sistemin e Auditimit të Brendshëm.

Opinion

Auditori i Përgjithshëm (AP) i raporton Kuvendit për opinionin e tij në formatin e përcaktuar në nën kapitullin 2.3 - Opinioni i Auditimit. Shtojca I shpjegon llojet e ndryshme të opinionëve të aplikuar nga ana e ZAP. Raporti i AP-së përfshin një opinion për vërtetësinë dhe drejtësinë e PVF.

Sipas opinionit tonë Pasqyrat Vjetore Financiare në të gjitha aspektet materiale *prezantojnë një pamje të drejt dhe të plotë*, me përjashtim të:

Mos prezantimit të pagesave nga palët e treta. Te pasqyra e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, tek shtylla pagesat nga palët e treta, komuna nuk kishte prezantuar asnjë vlerë, ndërsa sipas ekzaminimeve të auditimit vlera e këtyre pagesave ishte 712,079€, dhe

Te neni 13 Pasqyra e realizimit të buxhetit, shënimi 16 donacionet, komuna nuk kishte paraqitur asnjë vlerë, ndërsa sipas shënimeve të Free balance-it, vlera e këtyre donacioneve ishte 451,730€.

(SNISA 400: Opinioni i Kualifikuar)

Theksim i çështjes

Gjithashtu, dëshirojmë të tërheqim vëmendjen tuaj për faktin se evidencat dhe informatat e prezentuara tek shpalosjet e pasurive dhe stoqeve nuk ishin të sakta. Pasaktësitë janë si në vijim:

Te shënimi 30: Përmbledhja e pasurive jo financiare, edhe pse është shpalosur vlera prej 480,940,000€, kjo shumë nuk ishte e saktë për arsye se ne kemi identifikuar pasuri me vlerë prej 574,433€ që nuk ishin shpalosur në PVF; dhe

Te shënimi 32: Përmbledhja e stoqeve në fund të periudhës, komuna kishte prezantuar vlerën prej 7,000€, ndërsa sipas shënimeve që ne i kemi siguruar vlera e stoqeve ishte 18,789€, pra ekziston një diferencë prej 11,789€.

Konkluzioni i përgjithshëm

Konkluzioni ynë i përgjithshëm pasqyron rishikimin tonë të kontrolleve të ndërlidhura me PVF-të, Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, pajtueshmërinë e procedurave të pagesave dhe pranimeve, si dhe Sistemin e Auditimit të Brendshëm.

Konkluzioni ynë i përgjithshëm është se:

Është bërë një numër i përmirësimeve nga menaxhmenti në vitin 2012, të cilat e kanë rritur rangun e procedurave dhe proceseve të kontrollit financiar, për shembull kanë përmirësuar regjistrimin e pasurive, fuqizimi i komitetit të auditimit. Megjithatë, mbetet hapësirë për përmirësime për të siguruar aplikim gjithëpërfshirës dhe konsistent të kontrolleve të duhura nëpër të gjitha aktivitetet e Komunës, me theks të veçantë në Përgaditjen e PVF-ve në pajtim me kërkesat ligjore. Dobësitë në detaje janë përshkruar më poshtë.

Rekomandimet e auditimit kanë për qëllim ta mbështesin Komunën e Prizrenit në përmirësimin e kontrolleve financiare dhe rritjen e aspekteve tjera të aktivitetit operacional. Ne i kemi konsideruar përgjigjet ndaj rekomandimeve tona të bëra në vitin 2011 - pozita aktuale është përmbledhur në Shtojcën II. Konkluzioni ynë i përgjithshëm është se kërkohet theks shtesë në implementimin e rekomandimeve të auditimit për t'iu shmangur dobësive të vazhdueshme të kontrollit.

Ne e kemi diskutuar cilësinë e kontrollit financiar të komunës dhe gjetjet e auditimit në kontekstin e Pasqyrave Vjetore Financiare, menaxhimit financiar dhe kontrolleve, dhe llogaridhënies menaxheriale dhe auditimit të brendshëm me organet drejtuese të komunës.

Rekomandimet tona kryesore për Kryetarin e Komunës janë si në vijim:

Pasqyrat vjetore financiare

- Kryetari i Komunës duhet të siguroj që PVF të përgatiten në harmoni të plotë me Rregullën e Thesarit nr.07/2011, me të gjitha informatat përcjellëse.

Menaxhimi financiar dhe kontrolli

- Të përmirësoj politikat e planifikimit të mirëfilltë të buxhetit, duke kryer të gjitha analizat sipas sektorëve dhe duke priorizuar nevojat reale për secilën kategori;
- Të rrisë kontrollet tek të hyrat nga lejet e ndërtimit, duke siguruar fillimisht një bazë të të dhënave të plota dhe të sakta dhe të vendos mekanizma efikas për mbledhjen e borxheve të vjetra;
- Të shtojë kontrollet tek procesi i prokurimit, duke respektuar kriteret e vendosura në dosjen e tenderit;
- Të mos ketë ndarje të tenderëve, me qëllim të shmangies së procedurave të hapura të prokurimit;
- Të aprovoj Rregulloren për Subvencione dhe Transfere;
- Të forcoj në vazhdimësi sistemin e kontrollit të brendshëm, për të eliminuar dobësitë ekzistuese të sistemit; dhe
- Të regjistrohen të gjitha pasuritë që janë në pronësi të komunës dhe të azhurnohen regjistrat e pasurive në vazhdimësi.

Sistemi i auditimit të brendshëm

- Menaxhmenti duhet t'i kushtoj vëmendje më të madhe adresimit të rekomandimeve të NJAB-it; dhe
- Se NJAB-i do të plotësohet me stafin shtesë të nevojshëm sipas kërkesave të udhëzimit administrativ nr. 23/2009.

Përgjigja nga Menaxhmenti – auditimi për 2012

Menaxhmenti është pajtuar me të gjitha gjetjet e auditimit dhe është zotuar se do t'i adresoj rekomandimet tona.

1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit

Është përgjegjësi e Menaxhmentit të përgatis PVF sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (SNKSP) për “Raportimin Financiar në bazë të Kontabilitetit të Parasë së Gatshme”. Zyra e Auditorit të Përgjithshëm është përgjegjëse për kryerjen e auditimit të rregullsisë që përfshin ekzaminimin dhe vlerësimin e pasqyrave financiare dhe të dhënave tjera financiare si dhe dhënien e opinionëve:

- Nëse PVF-të japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Për përshtatshmërinë e funksioneve të kontrollit të brendshëm dhe të auditimit të brendshëm; dhe
- Për të gjitha çështjet të cilat dalin apo kanë të bëjnë me auditimin.

Puna e ndërmarrë e auditimit ka reflektuar vlerësimin e rrezikut tonë të auditimit për Komunën e Prizrenit. Ne kemi konsideruar të kuptuarit tonë për organizatën, deri në çfarë mase mund të mbështetemi në kontrollet menaxheriale dhe nivelin e testimit të hollësishëm të kërkuar gjatë përcaktimit të testeve të përgjithshme e që janë të nevojshme për të siguruar nivelin e nevojshëm të dëshmive për të mbështetur opinionin e Auditorit të Përgjithshëm.

Seksionet e mëposhtme ofrojnë një përmbledhje më të detajuar të të gjeturave tona të auditimit me theks të veçantë në vëzhgimet dhe rekomandimet në çdo fushë të rishikimit. Një vlerësim i përgjigjeve të Menaxhmentit ndaj rekomandimeve të bëra në vitin 2011 mund të gjendet në Shtojcën II.

Ne kemi përfshirë të gjeturat e rëndësishme dhe të tjera më pak të rëndësishme, që dalin nga auditimi ynë. Për plotësinë ne kemi përfshirë çështjet e identifikuar gjatë auditimit të 9 mujorit aty ku ishte relevante. Të gjeturat tona janë definuar si:

Të rëndësishme - Çështjet kryesore për vëmendjen e atyre që janë të ngarkuar me qeverisje dhe menaxhmenti i lartë e që mund të ketë potencial të rezultojë në një dobësi materiale në kontrollet e brendshme; dhe

Të tjera - Dobësitë e identifikuar në auditimin tonë, ku veprimi do të ofrojë potencialin për përmirësime në efikasitet dhe efektivitet të kontrolleve të brendshme.

Procedurat tona kanë përfshirë një rishikim të kontrolleve të brendshme dhe sistemeve të kontabilitetit dhe procedurat vetëm deri në atë masë që konsiderohet e nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen sikur

përfaqësojnë një deklaratë gjithëpërfshirëse të të gjitha dobësive të cilat ekzistojnë, apo edhe të gjitha përmirësimet që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë funksionuar.

2 Pasqyrat vjetore financiare

Rishikimi ynë i PVF-ve merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë dhe saktësinë e informatave të regjistruara në PVF. Ne gjithashtu e konsiderojmë deklaratën e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe Financiar, kur draft PVF-të dorëzohen në Qeveri.

Deklarata në lidhje me prezantimin e PVF-ve përfshin një numër të pohimeve për sa i përket pajtueshmërisë me kornizën raportuese dhe cilësinë e informacionit në kuadër të PVF. Një numër i pikëve në deklaratë kanë për qëllim të ofrojnë siguri për Qeverinë se të gjitha informatat relevante janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një auditim gjithë përfshirës.

2.1 Pajtueshmëria me kornizën raportuese

Konkluzioni i përgjithshëm

PVF ishin përgatitur sipas formatit standard që kërkohet me Rregullën Financiare nr. 07/2011, mirëpo ne gjatë auditimit kemi konstatuar se disa të dhëna të prezantuara në PVF ishin të pasakta dhe jo të plota. Më gjërësisht ato do t'i paraqesim tek nënkapitulli 2.2 Cilësia dhe saktësia e informatave.

Përshkrimi

PVF duhet të jenë në përputhje me kornizën e caktuar raportuese. Ne kemi vërejtur se:

- PVF janë përgatitur brenda kornizës kohore dhe janë dorëzuar në MF;
- PVF janë nënshkruar nga Zyrtari Kryesor Administrativ (Kryetari i Komunës) dhe Zyrtari Kryesor Financiar;
- PVF janë pranuar në gjuhën shqipe dhe serbe;
- PVF janë përgatitur në kopje fizike dhe elektronike; dhe
- Komuna ka përgatitur dhe ka dorëzuar raporte të rregullta tremujore tek Ministri i MF gjatë vitit 2012.

2.2 Cilësia dhe saktësia e informatave të prezantuara në pasqyrat vjetore financiare

Konkluzioni i përgjithshëm

PVF-të të komunës të përgatitura me datë 31.01.2013 për vitin e përfunduar me 31.12.2012, nuk ishin në pajtim me kërkesat që dalin nga Rregulla Financiare nr. 07/2011. Ato ishin jo të plota dhe të pasakta.

1. Çështja - Procesi i Përgatitjes së PVF-ve - Prioriteti - I rëndësishëm

E gjetura Te neni 12: Pasqyra e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, tek shtylla pagesat nga palët e treta, komuna nuk kishte paraqitur asnjë vlerë, ndërsa sipas shënimeve që ne i kemi siguruar nga komuna, vlera e pagesave nga palët e treta ishte 712,079€.

Te neni 13: Pasqyra e realizimit të buxhetit, shënimi 16 Donacionet te shtyllat e buxhetit final dhe realizimi, komuna nuk kishte paraqitur asnjë vlerë, ndërsa sipas shënimeve nga Free balance, donacionet e ndara për komunën ishin në vlerë 451,730€.

Te shënimi 32: Përmbledhja e stokeve në fund të periudhës, komuna kishte prezantuar vlerën 7,000€, ndërsa sipas shënimeve që ne i kemi siguruar nga zyrtarët e depos, vlera e stokeve ishte 18,789€, një diferencë prej 11,789€.

Te shënimi 30: Përmbledhje e pasurive jo financiare, vlera e pasurive që është prezentuar në PVF nuk është e saktë, pasi që në të nuk janë përfshirë të gjitha pasuritë që janë në posedim të komunës. Ne kemi identifikuar pasuri me vlerë 574,433€ që nuk janë prezentuar në PVF.

Rreziku Pasqyrat vjetore financiare janë të mangëta dhe përmabajnë gabime. Regjistrat e kontabilitetit janë të pamjaftueshëm për të mbështetur vendimet e menaxhmentit, për të bërë proceset dhe konsideratat buxhetore.

Rekomandimi 1 Kryetari i Komunës duhet të sigurojë që PVF-të për 2013 formalisht adresojnë të gjitha kërkesat e pajtueshmërisë dhe përfshijnë rishikimin e rekomandimeve të bëra nga ZAP në vitin 2012.

2.3 Opinioni i Auditimit

Sipas opinionit tonë Pasqyrat Vjetore Financiare në të gjitha aspektet materiale prezantojnë një pamje të drejt dhe të plotë, me përjashtim të:

Mos prezantimit të pagesave nga palët e treta. Te pasqyra e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, tek shtylla pagesat nga palët e treta, komuna nuk kishte prezantuar asnjë vlerë, ndërsa sipas ekzaminimeve të auditimit vlera e këtyre pagesave ishte 712,079€, dhe

Te neni 13 Pasqyra e realizimit të buxhetit, shënimi 16 donacionet, komuna nuk kishte paraqitur asnjë vlerë, ndërsa sipas shënimeve të Free balance-it, vlera e këtyre donacioneve ishte 451,730€.

(SNISA 400: Opinion i Kualifikuar)

Theksim i çështjes

Gjithashtu, dëshirojmë të tërheqim vëmendjen tuaj për faktin se evidencat dhe informatat e prezentuara tek shpalosjet e pasurive dhe stokeve nuk ishin të sakta. Pasaktësitë janë si në vijim:

Te shënimi 30: Përmbledhja e pasurive jo financiare, edhe pse ishte shpalosur vlera prej 480,940,000€, kjo shumë nuk ishte e saktë për arsye se ne kemi identifikuar pasuri me vlerë prej 574,433€ që nuk janë shpalosur në PVF; dhe

Te shënimi 32: Përmbledhja e stokeve në fund të periudhës, komuna kishte prezantuar vlerën prej 7,000€, ndërsa sipas shënimeve që ne i kemi siguruar vlera e stokeve ishte 18,7891€, pra ekziston një diferencë prej 11,789€.

3 Rekomandimet e vitit paraprak

Konkluzioni i përgjithshëm

Menaxhmenti i komunës kishte trajtuar rekomandimet tona të dhëna vitin e kaluar, por niveli i adresimit të tyre mbetet i ultë, për të siguruar se dobësitë dhe mangësitë e identifikuar janë korrigjuar.

Përshkrimi

Raporti ynë i auditimit për PVF-të të vitit 2011 ka rezultuar në 9 (nëntë) rekomandime. Menaxhmenti i komunës ka përgatitur një Plan Veprimi duke theksuar se të gjitha rekomandimet do të adresohen.

Në fund të auditimit ne kemi vërejtur se, 2 (dy) rekomandime ishin adresuar plotësisht; 3 (tre) ishin adresuar pjesërisht apo janë në proces të adresimit, dhe 4 (katër) nuk ishin adresuar. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe se si janë adresuar ato, shih Shtojcën II në fund të këtij raporti.

2. Çështja - Adresimi i rekomandimeve nga viti paraprak - Prioriteti - I rëndësishëm

- | | |
|----------------------|---|
| E gjetura | Komuna kishte adresuar vetëm pjesërisht rekomandimet e dhëna në vitin paraprak. |
| Rreziku | Mos adresimi i rekomandimeve në formë të plotë, tregon se në disa fusha vazhdojnë të ekzistojnë problemet e njëjta nga viti 2011, si dhe të përsëriten rekomandimet e vitit të kaluar. |
| Rekomandimi 2 | Kryetari i Komunës duhet të sigurojë që plani i veprimit i rishikuar në mënyrë të qartë përcakton një afat kohor për adresimin e rekomandimeve me anëtarët e stafit llogaridhënës të identifikuar me fokus fillesar në ato të një rëndësie më të madhe. |

4 Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli

4.1 Hyrje

Qasja jonë e auditimit është fokusuar në të kuptuarit dhe vlerësimin e veprimeve të ndërmarra nga menaxhmenti për të siguruar menaxhim financiar dhe kontroll efektiv. Për sisteme individuale financiare, ne kërkojmë të identifikojmë nivelin në të cilin operojnë kontrollet aktuale. Kjo mund për shembull, të jetë aktiviteti monitorues i ndërmarra nga menaxhmenti i lartë apo kontrolleve operative të nivelit më ulët. Kjo kërkon një vlerësim të strukturave, proceseve dhe linjat e llogaridhënies të prezantuara nga menaxhmenti.

Ne konsiderojnë vetë-vlerësimin e bërë nga menaxhmenti i komunës sipas kërkesave të menaxhimit financiar dhe kontrolleve.

4.2 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

Konkluzioni i përgjithshëm

Komuna ka shpenzuar buxhetin në masën 91% sipas rregullave që janë në fuqi dhe në suazat e përcaktuara nga kuvendi. Një shpenzim më i ultë është shënuar tek shpenzimet kapitale prej rreth 83% të buxhetit. Arsye për mos shpenzim të mjeteve tek kjo kategori ishin vonesat në realizimin e projekteve, si dhe mos realizimi i të hyrave vetjake të palnifikuara që kanë qenë të parapara për projekte kapitale.

Përshkrimi

Ne kemi konsideruar burimin e fondeve buxhetore për Komunën e Prizrenit, shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike dhe të hyrave të mbledhura. Kjo është theksuar në tabelat e mëposhtme.

Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore – realizimi ndaj buxhetit (në euro)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final ¹	2012 Shpenzimi	2011 Shpenzimi	2010 Shpenzimi
Burimet e Fondeve	31,595,018	33,165,749	30,274,490	32,018,274	25,229,783
Granti i Qeverisë-Buxheti	26,104,343	26,154,343	25,683,770	26,073,952	21,119,192
Të bartura nga viti paraprak –	-	1,069,000 ²	976,455	1,436,952	734,910
Të hyrat vetanake	5,490,675	5,490,675 ³	3,317,382	3,892,448	3,033,560
Donacionet Vendore	-	243,815	125,611	167,400	284,442
Donacionet e Jashtme	-	207,916	171,272	447,522	57,679

Buxheti Final ndryshon nga Buxheti Fillestar për 1,570,731€. Ky ndryshim është për shkak të bartjes së të hyrave vetjake nga viti i kaluar, në shumë prej 1,069,000€, granteve të papërcaktuara të donatorëve në shumë prej 451,731€, si dhe dhënia e 50,000€ me vendim të Qeverisë për projektin Kapital Ndërtimi i rrugës Kurilë-Novoselan në Prizren.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike- realizimi ndaj buxhetit (në euro)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2012 Shpenzimi	2011 Shpenzimi	2010 Shpenzimi
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike	31,595,018	33,165,749	30,274,490	32,018,274	25,229,783
Pagat dhe Mëditjet	14,830,293	14,897,153	14,856,793	14,403,387	11,129,125
Mallrat dhe Shërbimet	2,186,459	2,337,815	2,082,843	2,133,270	2,340,380
Komunalitë	706,534	806,534	802,796	638,217	616,552
Subvencionet dhe Transferet	360,979	360,979	350,288	351,636	372,004
Investimet Kapitale	13,510,753	14,763,268	12,181,770	14,491,764	10,771,722

¹ Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi që është e përshtatur vazhdimisht nga Ministria e Financave

² Të hyrat vetanake të Komunave të pashpenzuara në vitin paraprak të bartura në vitin aktual.

³ Të hyrat vetanake komunale të planifikuara.

Tabela 3. Të hyrat vetjake komunale të buxhetuara dhe të mbledhura në 2012 (në euro)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2012 Pranimi	2011 Pranimi	2010 Pranimi
Të hyrat vetanake	5,490,675	5,490,675	4,339,726	4,999,000	4,434,000

Komuna kishte realizuar 79% të hyrave të planifikuara. Ngecjet në realizimin e të hyrave më të theksuara ishin tek të hyrat nga Licencat komerciale biznesore dhe gjobat e trafikut. Nëse i krahasojmë rënien e të hyrave të vitit 2012 për 15% në raport me vitin 2011, shohim se kjo ka ndodhë kryesisht për shkak të gjobave të trafikut, që nuk ishin realizuar sipas planit të paraparë, si dhe të hyrave nga licencat për veprimtari biznesore.

4.3 Kërkesat e raportimit

Konkluzioni i përgjithshëm

Komuna, sa i përket kërkesave të raportimit jashtëm financiar, mund të konkludojmë se i ka përmbushur dhe ka respektuar afatet e kërkuara.

Përshkrim

Ne kemi konstatuar se Komuna e Prizrenit i ka përmbushur të gjitha obligimet për raportim të jashtëm. Obligimet e përmbushura janë paraqitur në vijim:

- Kërkesa Buxhetore për financimin e projekteve kapitale në Ministrinë e Financave;
- Raportet tremujore, duke përfshirë pasqyrat financiare nëntë mujore me kohë;
- Draft Plani dhe plani përfundimtar i prokurimit me kohë;
- Raportet Operacionale (performancës);
- Raportet mbi borxhet e dorëzuara në MF;
- Plani i Veprimit për implementimin e rekomandimeve; dhe
- Raportet mbi kontrollet e brendshme, duke përfshirë raportin e vetëvlerësimit.

4.4 Të hyrat (përfshirë të hyrat vetjake)

Konkluzion i përgjithshëm mbi të hyrat

Komuna e Prizrenit formalisht ka vendosur kontrolle mbi të hyrat, por kontrollet si të tilla kërkojnë përmirësime të mëtejshme sidomos në sigurimin e një baze të të dhënave të plota mbi lejet e ndërtimit dhe pronat e dhëna me qira, duke u siguruar se qiramarrësit i kryejnë obligimet sipas kontratës ndaj komunës. Komuna duhet nxjerrë politika të qarta me mekanizmat e duhur se si të inkasohen borxhet e mbetura nga vitet paraprake.

Përshkrimi

Të hyrat e gjeneruara nga Komuna e Prizrenit në vitin 2012 ishin në total 4,339,737€. Burim i këtyre të hyrave ishin të hyrat nga tatimi në pronë, të hyrat nga lejet e ndërtimit, taksat administrative, etj.

3. Çështja - Tatimi në pronë - Prioriteti - I rëndësishëm

E gjetura Komuna nga tatimi në pronë për vitin 2012 kishte planifikuar të realizoj shumën 1,156,000€, ndërsa kishte inkasuar shumën prej 1,234,040€. Ne kemi testuar 48 mostra nga tatimi në pronë në vlerë prej 189,272€, dhe kemi konstatuar se në 5 raste janë paguar tatim në pronë 8,099€, ndërsa në 43 raste nuk kanë paguar fare. Po ashtu, shumata e obligimeve të grumbulluara nëpër vite arrin vlerën prej 5,288,507€. Komuna nuk kishte hartuar ndonjë plan apo strategji se si të inaksoj borxhet e vjetra.

Rreziku Tatimi në pronë është i vetmi tatim që inkason komuna dhe paraqet njërin nga burimet kryesore të të hyrave. Neglizhenca në mbledhjen e këtij tatimi rrit rrezikun që të hyrat e planifikuara të mos inkasohen dhe redukton mundësinë e realizimit të projekteve të planifikuara me vetëfinancim.

Rekomandimi 3 Kryetari i Komunës duhet të ketë një çasje gjithëpërfshirëse në trajtimin e të hyrave, si në kuptimin e planifikimit ashtu edhe në vendosjen e mekanizmave efektiv për realizimin e parametrave të planifikuar. Menaxhmenti duhet të inicioj një proces rivlerësimi, ku të gjitha llogaritë do të analizohen në kuptimin e vjetërsisë, shumave domethënëse, mundësive reale për inkasim dhe ushtrimin e masave administrative (nëse ka nevojë).

4. Çështja - Lejet e ndërtimit - Prioriteti - I rëndësishëm

- E gjetura** Komuna nga lejet e ndërtimit për periudhën e vitit 2012 kishte planifikuar që të realizoj të hyra në vlerë 800,000€, ndërsa kishte inaksuar 843,346€. Ne kemi testuar 8 mostra në vlerën 274,582€ dhe kemi identifikuar këto mangësi:
- Ne nuk ishim në gjendje të sigurojmë një bazë të plotë të të dhënave për numrin e kërkesave për leje, lejet e lëshuara, dhe refuzimet për vitin 2012; dhe
 - Në tri raste kemi konstatuar se komuna kishte lëshuar vendim për ndërtimin e dy kateve, ndërsa inspektorët në terren kanë vërejtur tejkalime në ndërtimin e objekteve dhe janë ndërtuar më shumë kate se sa është përcaktuar me leje ndërtimi.
- Rreziku** Mungesa e një baze të plotë të të dhënave për lejet e ndërtimit, si dhe tejkalimi i kateve të lejuara të ndërtimit, rritë rrezikun që tarifat të mos kalkulohen saktë dhe të kemi një nënpagesë të të hyrave.
- Rekomandimi 4** Kryetari i Komunës duhet ta krijojë një bazë të saktë të të dhënave se sa ka qenë numri i kërkesave për leje, lejet që janë lëshuar dhe ato që janë refuzuar. Po ashtu, rastet e tejkalimit të ndërtimeve duhet të rishikohen dhe si të tilla ose të ndërpriten ose të paguhen tarifat shtesë.

5. Çështja - Të hyrat nga pronat e dhëna me qira - Prioriteti - I rëndësishëm

- E gjetura** Komuna nga pronat e dhëna me qira kishte planifikuar të realizoj 420,284€, ndërsa kishte inkasuar 290,863€. Ne kemi testuar 10 mostra dhe kemi identifikuar këto mangësi:
- Në një rast komuna kishte lidhur kontratë në vitin 2008 me një qiramarrës për shfrytëzimin e lokalit afarist me vlerë 1,025€/muaj dhe qiramarrësi nuk kishte respektuar kontratën. Kryetari me një konkluzion të nxjerrë me datë 13.07.2010 ia zvogëlon qiranë në 850€, por sërish qiraja nuk ishte paguar. Qiraja e papaguar kishte arritur në 16,265€.
 - Në një rast tjetër, në vitin 2002 komuna kishte lidhur kontratë për qiradhënie për gjashtë vite, me mundësi vazhdimi edhe për katër të tjera, ndërsa komuna kishte lidhur kontratë të re në vitin 2012 edhe për katër vite që bie ndesh me kontratën bazë. Qiramarrësi nuk kishte paguar qiranë në baza të rregullta dhe obligimi i pa paguar ndaj komunës kishte arritur në 51,400€.
 - Në katër raste komuna kishte lidhur kontratë me qiramarrës për shfrytëzimin e pronës dhe lokaleve afariste. Në të gjitha rastet qiramarrësit nuk kishin bërë asnjë pagesë për qira. Obligimi i përgjithshëm ishte 44,109€. Komuna kishte ngritur padi në gjykatë për mos kryerje të obligimeve.
- Rreziku** Mos pagesa e obligimeve sipas kontratave nga qiramarrësit dhe zvogëlimi i qirasë me konkluzion të kryetarit rrisin rrezikun e shmangies ligjore të pagesave nga qiramarrësit dhe zvogëlimin e të hyrave.
- Rekomandimi 5** Kryetari i Komunës duhet të siguroj se të gjitha obligimet kontraktuese zbatohen në baza të rregullta mujore nga qiramarrësit. Në të kundërtën, komuna duhet të ndërprej kontratat. Një rishikim i vazhdueshëm i kontratave dhe forcimi i kontrolleve duhet të bëhet nga menaxhmenti.

6. Çështja - Taksat për veprimtari biznesore – Prioriteti - I rëndësishëm

- E gjetura** Komuna kishte planifikuar të realizoj të hyra nga kjo veprimtari në vlerë 600,000€, ndërsa kishte realizur shumën 272,467 apo 45%. Një ndryshim aq i madh në mes planit dhe realizimit është për shkak se kjo lloj takse më nuk inkasohet nga komuna. Borxhi i përgjithshëm nga kjo kategori e të hyrave ndaj komunës prej vitit 2001 deri më 2012 është 7,161,205€.
- Rreziku** Mos realizimi i borxheve të vjetra që kanë mbetur nga vitet paraprake ndikon në zvogëlimin e buxhetit në total, si dhe mosrealizimin e shumë projekteve të planifikuara me vetëfinancim.
- Rekomandimi 6** Kryetari i Komunës duhet të shtojë aktivitetin për ta rritur inaksimin e borxheve të mbetura nga vitet paraprake.

4.5 Shpenzimet

Konkluzion i përgjithshëm mbi shpenzimet

Komuna ndonëse ka të dizajnuara kontrole formale mbi shpenzimet, nga testimet tona ka rezultuar se ato nuk operojnë në mënyrën e duhur. Pagesat për disa artikuj jashtë specifikacionit teknik, ndarja e tenderëve për t'iu shmangur procedurave të hapura, shpërblimi i ofertuesve të papërgjegjshëm, janë vetëm disa raste që përshkruajnë dështimin e kontrolleve.

4.5.1 Prokurimi

Përshkrimi

Kontratat që kanë kaluar nëpërmjet procedurave të prokurimit për vitin 2012 ishin në vlerë prej 13,630,167€.

Ne kemi analizuar nëse projektet për investime kapitale kanë qenë të përfshira në PIP dhe në kornizën afatmesme të shpenzimeve. Gjithashtu kemi rishikuar se mos ka ndodhur ndonjë ndryshim gjatë vitit lidhur me projektet e parapara të realizohen gjatë vitit. Ne kemi vlerësuar se nuk ka pasur ndonjë çështje lidhur me këto për të ngritur në këtë raport.

Ne kemi ekzaminuar 89 mostra (pagesa) që kapin vlerën prej 4,590,850€. Përveç rasteve të identifikuar në vijim, procedurat e prokurimit ishin konform rregullativës ligjore në fuqi.

7. Çështja - Mos respektim i kriterit të vendosur në dosjen e tenderit-Prioriteti - I rëndësishëm

- E gjetura** Tek kontrata “Punimi i rrethojës së oborrit të shkollës fillore në fshatin Zhur” në vlerë 38,905€, dy kompani kishin ofertuar si konzorcium ku njëra nuk i kishte plotësuar kriteret e kërkuara me dosjen e tenderit si, pajisjet teknike, referenca për punë të ngjashme, lista e stafit e vërtetuar nga Administrata Tatimore e Kosovës).
- Në kontratën “Ndërtimi i kulmit të objektit shkollor Abdyl Frashëri në Prizren” në vlerë prej: 64,217€, kriter obligativ në dosjen e tenderit ishte që operatori ta ketë deklaratën e menaxherit të projektit, ku kompania fituese nuk e kishte sjellur këtë dokument.
- Në kontratën furnizim me dru për nevojat e shkollave në komunën e Prizrenit në vlerë prej 147,934€, kriter në dosjen e tenderit ishte që operatori ekonomik t’i ketë në depo 20% stoqe të masës drusore, ndërsa ne kemi konstatuar se kompania fituese nuk kishte ofruar dëshmi që konfirmon se kishte në stoqe këtë sasi, siç kërkohet në dosjen e tenderit.
- Rreziku** Mos respektimi i kriterëve të vendosura në dosjen e tenderit gjatë vlerësimit të ofertave rrit rrezikun e përzgjedhjes së ofertuesve të papërgjegjshëm.
- Rekomandimi 7** Kryetari i Komunës duhet të siguroj se në të gjitha rastet e prokurimit, vlerësimi i ofertave bëhet në mënyrë objektive dhe në mënyrë strikte respektohen të gjitha kriteret e vendosura në dosjen e tenderit.

8. Çështja - Shpenzimet e mirëmbajtjes dhe riparimit të automjeteve - Prioriteti I rëndësishëm

E gjetura Rishikimi i pagesave për mirëmbajtje dhe riparim të automjeteve ka identifikuar se:

- Komuna kishte bërë shpenzime të pa kontraktuara dhe pa procedura të prokurimit për mirëmbajtjen dhe riparimin e automjetit të kryetarit në vlerë prej 3,977€. Këto shpenzime i takonin periudhave nga 2008 deri 2012-të. Ne kemi rishikuar këto pagesa dhe kemi vërejtur se ishte bërë pagesë e dyfishtë e faturës 1892/S në vlerë prej 336€. Kjo faturë ishte prezantuar në faturën përmbledhëse me nr 001 të datës 10.04.2012 dhe po ashtu edhe si faturë e veçantë e datës 12.12.2011.
- Në tenderin e hapur për servisim dhe mirëmbajtje të automjeteve të ndarë në dy lote, komuna kishte lidhur kontratë me OE "Rex Automobile" për furnizim me pjesë Lot 1 dhe OE D.P.Z "LML-COM" për servisim dhe transportim të automjeteve, Lot 2. Ne kemi rishikuar pagesa në vlerë prej 4,737€ ndaj "LML-COM" dhe kemi vërejtur se komuna ishte furnizuar me pjesë për automjete në vlerë prej 3,585€, ndonëse nuk ishin të kontraktuara me këtë Operator.

Rreziku Dështimi i ndjekjes së procedurave të duhura të prokurimit dhe udhëzimeve shoqëruese ka rezultuar me pagesa të pa rregullta dhe humbje financiare për Komunën. Ekziston rrezik i mëtejme se është arritur vlerë e dobët për parane e shpenzuar për këtë kontratë.

Rekomandimi 8 Kryetari i Komunës duhet të shqyrtoj arsyet pse kërkesat e prokurimit publik nuk janë aplikuar në këto raste dhe të sigurojë që janë vendosur kontrollet e duhura, në mënyrë që situata të tilla të mos përsëriten.

9. Çështja - Ndarja e tenderëve për t'iu shmangur procedurave të hapura të prokurimit - Prioritet tjetër

- E gjetura** Tek kontrata Dizajnimi dhe shtypja e Guidës së Xhepit "Vizitorët" në qytetin e Prizrenit, dhe Dizajnimi dhe shtypja e Guidës arkeologjike në qytetin e Prizrenit në vlerë prej 9,930€ dhe 9,950€, kërkesa ishte bërë nga Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Turizmit në datën e njejtë 05.07.2012. Departamenti i prokurimit për shërbime të ngjashme kishte aplikuar kuotim të çmimeve, me qëllim për t'iu shmangur procedurave të hapura të tenderimit, ku për të dy kontratat është përzgjedhur operatori ekonomik i njejtë.
- Rreziku** Ndarja e tendreve për t'iu shmangur procedurave të hapura të prokurimit paraqet rrezik potencial se do ketë shpenzime më të larta për mallrat apo shërbimet e blera dhe nuk ofron mundësi të barabartë konkurruesve tjerë.
- Rekomandimi 9** Kryetari i Komunës duhet të siguroj se gjatë kërkesave për furnizime, fillimisht të bëhet një planifikim më i mirë i nevojave, në mënyrë që mos të ketë ndarje të tenderëve për t'iu shmangur procedurave të hapura të prokurimit.

4.5.2 Kompensimet (pagat dhe mëditjet)

Përshkrimi

Buxheti i planifikuar për kategorinë e pagave dhe mëditjeve ishte 14,897,153€, ndërsa shpenzimet ishin maksimale - 14,856,793€, gati 100%.

Pagat dhe Mëditjet paguhen përmes një sistemi të centralizuar (payrollit). Kontrollat që operojnë në nivel lokal nga komuna kanë të bëjnë me a) kontrollin i pagesave çdo muaj duke i nënshkruar listën e pagave b) verifikimin e ndryshimeve të mundshme që mund të paraqiten përmes formularëve, c) rishikimin e buxhetit për këtë kategori dhe barazimet me thesarin.

Për këtë kategori testuam 49 mostra ku rishikuam pajtueshmërinë e listave të pagave me sistemin e payrollit në MAP. Po ashtu, kemi shikuar nëse pozitat e zyrtarëve dhe koeficientet janë në pajtueshmëri me formën e sistemit të payrollit dhe listës së pagave. Testet tona në këtë kategori kanë identifikuar çështjet në vijim:

10. Çështja - Procesimi i pagave - Prioriteti - I rëndësishëm

- E gjetura** Rishikimi i pagave të punonjësve ka identifikuar se Komuna:
- Kishte paguar një punonjëse në pushim të lehonisë me 100% të pagës për 4 mujorin e parë. Ligji i Punës parasheh që të paguhet 70% e pagës. Po ashtu, nuk ishte ndërprerë pagesa për muajin kur pagesa është dashtë të bëhet nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale për 50% të pagës mesatare në Kosovë.
 - Në një rast të kalimit nga shërbyes civil në staf politik për pozitën drejtor i Drejtorisë së Shëndetësisë kemi vërejtur se për shkak mos ndryshimeve me kohë, personi ishte paguar më shumë prej 348€.
 - Drejtorja e Arsimit vazhdon të ketë një numër prej 28 mësimdhënësish që kanë kontratë, mirëpo nuk janë futur në listën e pagave si punëtor të rregullt.
- Rreziku** Zyra e personelit nuk ka azhurnuar dosjet e personelit dhe për pasojë kanë ndodhur këto pagesa jo korrekte.
- Rekomandimi 10** Kryetari i Komunës përmes mekanizmave të vetë duhet ta bëjë një shqyrtim sistematik të Dosjeve të Personelit, për të siguruar se të gjitha ndryshimet lidhur me stafin janë përfshirë, dhe pagesat janë azhurnuar. Pagesat e bëra tepër, duhet t'i kthehen buxhetit të Kosovës brenda një periudhe të specifikuar kohore.

4.5.3 Subvencionet dhe Transferet

Përshkrimi

Buxheti i ndarë për kategorinë Subvencioneve dhe Transfereve ishte 360,979€, ndërsa shpenzimi ishte 350,288€. Këto subvencione ndahen kryesisht për entitete publike dhe entitete jo publike (individë), me konkluzione të kryetarit të komunës. Ne kemi testuar 24 mostra në këtë kategori në vlerë prej 101,591€ dhe kemi identifikuar çështjet në vijim:

11. Çështja - Baza Ligjore - Prioriteti - I rëndësishëm

E gjetura Komuna nuk ka një rregullore të shkruar për ndarjen e mjeteve financiare për subvencioneve.

Rreziku Mungesa e politikave/rregulloreve të brendshme, reflekton mangësinë e procedurave që duhet ndiqen me rastin e subvencionimeve.

Rekomandimi 11 Kryetari i Komunës duhet që pa vonesë të miratoj një Rregullore që specifikon qartë kriteret, procedurat dhe burimet e subvencioneve.

12. Çështja - Përzgjedhja e Operatorit Ekonomik dhe mungesa e dokumentacionit mbështetës - Prioriteti - I rëndësishëm

E gjetura Drejtoria e Emërgjencës kishte angazhuar një OJQ për trajnimin dhe përgatitjen e zjarrfikësve, duke paguar një shumë prej 5,440€. Ne nuk ishim në gjendje të identifikonim se çfarë trajnimesh konkrete ishin ofruar dhe se si ishte përzgjedhur përfituesi i këtij subvencioni. Për më tepër, përfituesi nuk kishte ofruar një raport financiar për mënyrën e shfrytëzimit të këtyre mjeteve.

Shqyrtimi i dojseve të përfituesve nga entitetet publike ka identifikuar se:

- Te nëntë lëndë të përfituesve të ndyshëm, kemi konstatuar se mungonin kërkesat nga ana e përfituesve;
- Tek subvencionimi i punëtorëve të Qendrës së Mjeksisë Familjare në vlerë 3,360€ qëllimi i kërkesës ishte Vizita Sistematike në Shkollat fillore-mesme të ulta në Komunën e Prizrenit. Ndërsa subvencioni është përdorur për vizitë (workshop) në Shqipëri (Durrës dhe Tiranë).

Rreziku Mungesa e informatave kthyesë, siç janë raportet financiare dhe raportet tjera përshkruese, nuk sigurojnë se shpenzimet e planifikuara për subvencione dhe transfere kanë arritur qëllimin.

Rekomandimi 12 Kryetari i Komunës duhet që të siguroj se janë vendosur procedura dhe kontrolle të duhura për shpenzimet e subvencioneve, në pajtim me ndarjet fillestare.

4.6 Pasuritë

Konkluzioni i përgjithshëm mbi pasuritë

Komuna kishte vazhduar me kompletimin e regjistrave të pasurisë edhe këtë vit, dhe ne vlerësojmë angazhimet e bëra në këtë drejtim, ndonëse mbetet shumë punë për t'u bërë në të ardhmën. Një komision i inventarizimit dhe i vlerësimit ishin themeluar gjatë vitit, të cilët kishin përgatitur raporte për punën e tyre. Raporti i inventarizimit ishte përgatitur me vonesë, gjë që nuk ka reflektuar ndryshimet në regjistrat përfundimtar.

4.6.1 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale

Përshkrim

Në vitin 2011 vlera neto e pasurive në regjistrin kontabël ishte 467,539,000€, ndërsa në vitin 2012 ishte 480,940,000€.

13. Çështja - Regjistrimi dhe azhurnimi Prioriteti - I rëndësishëm

E gjetura Ne gjatë auditimit kemi identifikuar raste kur komuna nuk kishte regjistruar në regjistrat e pasurisë pasuritë si në vijim:

- Donacion nga CHF-ja (Cooprative Housing Foundation) për objekte arsimore në vlerë 415,617€;
- Objekte shëndetësore në vlerë prej 82,590€;
- Automjete në vlerë prej 76,226€;
- Automjetin e pranuar donacion nga Ministria e Administratës Publike.

Rreziku Mungesa e regjistrave të plotë të pasurive vështirëson identifikimin e pasurive për të konfirmuar ekzistencën e tyre, si dhe rritë rrezikun që ato të keqpërdoren, madje edhe të humben dhe tjetërsohen.

Rekomandimi 13 Kryetari i Komunës duhet të sigurojë që të gjitha pasuritë e blera të regjistrohen. Më tutje, të aplikojë procedura dhe kontrolle të duhura në identifikimin e të gjitha pasurive të pranuar donacion dhe t'i regjistroj konform UA 21/2009.

14. Çështja - Pajtueshmëri me Udhëzimet Administrative - Prioriteti - Tjetër

E gjetura Rishikimet tona kanë identifikuar çështje që nuk janë në pajtueshmëri me Udhëzimin Administrativ 21/2009 për menaxhimin e pasurive.

- Legjislacioni kërkon që Komisioni i inventarizimit të përgatitë raport para përfundimit të vitit fiskal. Raporti nuk ishte përgatitur me kohë, ai ishte aprovuar më 26.02.2013;
- Pasuritë e identifikuar jashtë përdorimit dhe që kanë munguar nga inventarizimi, nuk ishin trajtuar apo larguar nga regjistri i brendshëm;
- Pasuritë e pranuar si donacion nga EULEX-i në vlerë 38,905€, të cilat janë shitur më pastaj nuk janë larguar nga regjistri i brendshëm;
- Legjislacioni kërkon që zyrtari i pasurisë të jetë nën mbikqyrjen e Zyrtarit Kryesor Financiar. Zyrtari i pasurisë nuk është i vendosur nën mbikqyrjen e ZKF-së, mirëpo në kuadër të Departamentit të Administratës.

Rreziku Rastet e identifikuar më lartë tregojnë për kontrole të pamjaftueshme tek menaxhimi i pasurive. Kjo rritë rrezikun se pasuritë mund të tjetërsohen apo të mos konfirmohet vendndodhja fizike e tyre.

Rekomandimi 14 Kryetari i Komunës duhet të siguroj se do të forcojë kontrollet tek menaxhimi i pasurive, duke respektuar kërkesat që dalin nga udhëzimi administrativ mbi menaxhimin e pasurive.

4.7 Trajtimi i borxheve

Konkluzioni i përgjithshëm mbi trajtimin e borxheve

Komuna ka raportuar obligimet sipas rregullave të thesarit në Ministrinë e Financave dhe ka kontrole të mira në këtë fushë, pasi që në momentin që vijnë faturat nga operatorët ekonomik, procedohen për pagesë në Departamentin e Financave.

Përshkrim

Pasqyra e obligimeve të pakryera ndaj furnitorëve në fund të vitit 2012 ishte 932,661€. Këto detyrime janë bartur për t'u paguar në vitin 2013.

15. Çështja - Hyrje në obligime më shumë se sa buxheti i aprovuar - Prioriteti - I rëndësishëm

E gjetura Kemi vërejtur se komuna për kategoritë subvencione dhe komunali ka hyrë në obligime më shumë se ndarjet buxhetore. Buxheti i ndarë për subvencione ishte 360,979€ ndërsa ishin shpenzuar 350,288 apo 97%, ndërsa obligimet e pa paguara për këtë kategori ishin 79,390€. Gjithashtu edhe shpenzimet komunale ishin shpenzuar 802,795€ apo 100%, derisa obligimi i papaguar për këtë kategori në fund të vitit 2012 ishte 123,053€.

Rreziku Dobësitë në hartimin e buxheteve të nevojshme për kategorinë e subvencioneve dhe komunalive kanë shkaktuar krijimin e detyrimeve përtej parametrave të lejuar buxhetor. Hyrja në detyrime më shumë se sa buxheti i aprovuar mund ta sjellë komunën në vështirësi të papritura financiare dhe përballjen me konteste të mundshme gjyqësore.

Rekomandimi 15 Kryetari i Komunës përmes mekanizmave të vetë duhet të bëjë një planifikim të hollësishëm dhe real të buxhetit dhe se shfrytëzimi i fondeve bëhet në bazë të një plani të qartë të rrjedhës së parasë, duke mos tejkalar në asnjë rast fondet e alokuara sipas kategorive ekonomike.

5 Sistemi i auditimit të brendshëm

Konkluzion i përgjithshëm mbi sistemin e auditimit të brendshëm

Njësia e auditimit të brendshëm ka bërë një punë të mirë, duke kryer raporte në fusha të ndryshme për t'i ndihmuar menaxhmentit të lartë që ta ketë një pasqyrë rreth funksionimit të kontrolleve dhe aktiviteteve në komunë.

Përshkrimi

Sistemi i auditimit të brendshëm është një pjesë kyçe e kontrollit të brendshëm dhe për shkak të rëndësisë së tij ne e prezantojmë këtu ndaras. Ne e marrim parasysh fushëveprimin e punës së auditimit të brendshëm dhe aktivitetet e Komitetit të Auditimit.

NJAB-i për vitin 2012 kishte planifikuar të kryej pesë auditime sipas planit, dhe kishte arritë që ta realizoj planin në tërësi. Auditimet kishin mbuluar aktivitetet që kanë qenë në proces për vitin 2012 për këto fusha: (a) Buxhetit dhe financave, (b) Të hyrat vetjake në nivel të komunës, (c) Të hyrat vetjake për institucionet shkollore të komunës së Prizrenit, (d) Menaxhimi i pasurisë dhe (e) Auditimi në Zyrën e Prokurimit.

16. Çështja - Adresimi i rekomandimeve nga NJAB-i- Prioriteti - I rëndësishëm

E gjetura Ne gjatë auditimit kemi vërejtur se menaxhmenti vetëm pjesërisht kishte adresuar rekomandimet e auditimit të brendshëm.

Njab ka një auditor, i cili njëkohësisht është edhe drejtor njësie. Ai kishte përgatitë planin vjetor të auditimit, i cili është aprovuar nga menaxhmenti Komunës për vitin 2012. Duke u bazuar në udhëzimin administrativ nr.23/2009, përcaktohet se varësisht nga madhësia e buxhetit, të caktohet edhe numri i stafit auditues. Në bazë të këtij udhëzimi, komuna e Prizrenit duhej t'i kishte së paku 3 auditor kjo kërkesë ligjore nuk ishte plotësuar.

Rreziku Mos adresimi i rekomandimeve të dala nga NJAB-i rritë rrezikun që gabimet, mangësitë dhe dobësitë të përsëriten. Mungesa e stafit auditues ndikon që të mos arrihet të trajtohen të gjitha fushat me rrezik për biznesin e komunës.

Rekomandimi 16 Kryetari i Komunës duhet të bëjë plan veprimi dhe të përcaktoj se si mendon të adresoj rekomandimet e dhëna nga auditimi i brendshëm. Po ashtu, menaxhmenti duhet të shqyrtoj plotësimin e NJAB me stafin e nevojshëm.

6 Konkluzioni i përgjithshëm

Konkluzioni jonë i përgjithshëm e pasqyron rishikimin tonë të kontrolleve të ndërlidhura me PVF-të, Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin dhe të Sistemit të Auditimit të Brendshëm.

Konkluzioni ynë është se Menaxhmenti i Komunës kishte dizajnuar sistemin e kontrollit të brendshëm, por këto kontrolle kishin funksionuar dobët në të gjitha fushat e rëndësishme të menaxhimit financiar. Monitorimi ishte i dobët për t'u siguruar se kontrollet janë duke funksionuar siç duhet. Ne, në vazhdim po i paraqesim fushat në të cilat janë vërejtur mangësi më të theksuara:

PVF ishin përgatitur me shumë mangësi informatash, si: pagesat nga palët e treta, donacionet dhe shpalosja e stoqeve, të cilat si tërësi kalojnë kufirin e materialitetit dhe shpiejnë në kualifikimin e opinionit. Gjithashtu, shumë pasuri janë identifikuar si të pa regjistruara.

Rekomandimet e auditimit nga viti i kaluar nuk janë trajtuar në nivelin e kërkuar. Vetëm dy prej tyre ishin adresuar plotësisht, dhe gjysma e tyre nuk ishin trajtuar fare. Rasti i ngjashëm është edhe me zbatimin e rekomandimeve të auditimit të brendshëm.

Buxheti, ndonëse në përqindje ishte shpenzuar 91%, prapëseprapë kishte pasur mbetje gati prej tre milionësh, ndërsa në anën tjetër mbi 900 mijë euro kishin mbetur detyrime të pa paguara. Kjo nuk ofron një performancë gjithaq të mirë.

Të hyrat vetjake janë fusha më specifike ku dobësitë dhe magësitë janë posaçërisht të shprehura. Vetëm 79% të hyrave të planifikuara ishin realizuar dhe ishte shënuar një rënie prej 15% në krahasim me vitin e kaluar. Mbi 5 milionë janë borxhet e pa mbledhura nga tatimi në pronë për vite me radhë, kurse për objektet e dhëna me qira, gjithashtu janë grumbulluar shuma të mëdha të pa inkasuara.

Fusha e prokurimit, gjithashtu, shoqërohet me shumë parregullsi, të cilat shprehen sidomos: në mos respektimin e kriterëve në dosjet e tenderëve, furnizimet e artikujve jashtë kontratave, ndarja e tenderëve për t'iu shmangur procedurave të hapura, pagesat e dyfishta të faturave, pagesat e shërbimeve para pranimit teknik, etj.

Edhe në fushën e personelit janë evidentuar parregullsi, si në rekrutimin e stafit, ashtu edhe në pagesat e kryera jashtë kontratave.

Përkundër rekomandimeve të mëherëshme, komuna ende nuk ka nxjerrë ndonjë rregullore të brendshme të subvencioneve, dhe dokumentimi i pagesave nuk ishte i mjaftueshëm.

Kërkohen përmirësime substanciale të kontrolleve për t'i eliminuar mangësitë më lart.

Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZAP

(e shkëputur nga ISSAI 400)

9. Një opinion i auditimit normalisht është një format standard, ndërlidhur me pasqyrat financiare si tërësi, duke shmangur nevojën për të caktuar gjatësinë e saj por duke bartur sipas natyrës së saj një kuptim të përgjithshëm tek lexuesit sipas kuptimit të saj. Natyra e këtyre fjalëve do të ndikohet nga korniza ligjore të auditimit, por përbërja e opinionit duhet të tregoj qartë a është i pakualifikuar apo i kualifikuar, apo nëse është i kualifikuar në disa çështje të caktuara apo është opinion i kundërt (paragrafi 14), apo është mohim i opinionit (paragrafi 15).

10. Një **opinion i pakualifikuar** jepet kur auditori është i kënaqur në të gjitha aspektet materiale që:

- a) pasqyrat financiare janë përgatitur duke shfrytëzuar baza dhe politika të pranuar të kontabilitetit të cilat janë zbatuar në mënyrë konsistente (të qëndrueshme);
- b) pasqyrat janë në pajtim me kërkesat statusore dhe rregulloret relevante;
- c) pamja e paraqitur në pasqyrat financiare janë në përputhje me njohuritë e auditorit në lidhje me entitetin e audituar;
- d) është një shpalosje adekuate e të gjitha çështjeve materiale relevante për pasqyrat financiare.

11. **Theksi i çështjeve.** Në disa rrethana auditori mundet të konsideroj se lexuesi nuk do të kuptoj në mënyrë të duhur pasqyrat financiare nëse vëmendja është përqendruar në çështje të pazakonshme apo të rëndësishme. Si një rregull e përgjithshme, auditori kur jep një opinion të pakualifikuar kjo nuk i referohet ndonjë aspekti specifik të pasqyrave financiare në opinionin e tij në rast se kjo mund të interpretohet gabimisht si opinion i kualifikuar. Me qëllim të shmangies së kësaj përshtypjeje, referencat që janë menduar si; nënvizim i çështjes; gjinden në paragrafët e ndara nga opinionin. Sidoqoftë, auditori nuk duhet të përdor nënvizimin e çështjes për të përmirësuar mungesën e shpalosjeve të duhura në pasqyrat financiare apo si alternativ, zëvendësim për kualifikim të opinionit.

12. Auditori mund të mos jetë në gjendje të shpreh një opinion jo të kualifikuar kur ekziston një nga ato rrethana dhe në gjykimin e auditorëve, afektin e tyre është ose mund të jetë materiale për pasqyrat financiare:

- a) Ka pasur limitime në fushëveprimin e auditimit;
- b) Auditori konsideron që pasqyrat janë jo komplete apo çorientues apo ekziston një ndarje e pajustificuar nga standardet e pranueshme të kontabilitetit; apo
- c) Ekzistojnë paqartësi që ndikojnë në pasqyrat financiare.

13. **Opinion i Kualifikuar.** Aty ku auditori nuk pajtohet apo nuk është i sigurt në lidhje me një ose me tepër artikuj të veçantë në pasqyrat financiare e që janë materiale por jo edhe fundamentale në kuptimin e pasqyrave, duhet të jepet një opinion i kualifikuar. Formulimi i opinionit normalisht tregon një rezultat të kënaqshëm ndaj subjektit të audituar, sa i përket një pasqyre të qartë dhe koncize, të çështjeve të mospajtimit apo edhe të paqartësive që ngrisin opinion e kualifikuar. I ndihmon përdoruesit e pasqyrave nëse efekti financiar i paqartësisë apo edhe i mosmarrëveshjeve është përcaktuar nga ana e Auditorit edhe pse kjo nuk është gjithmonë praktike apo relevante.

14. **Opinion i Kundërt.** Aty ku Auditori nuk ka mundësi të jap një opinion mbi pasqyrat financiare në tërësi, për shkak të mosmarrëveshjeve që është aq thelbësore ngase e minon pozitën e prezantuar në vazhdim që opinionin që kualifikohet në aspekte të caktuara nuk do të jetë adekuat, atëherë jepet opinion i Kundërt. Formulimi i një opinionin të tillë e bën të qartë se pasqyrat financiare nuk janë prezantuar në mënyrë të drejtë, duke specifikuar qartë dhe në mënyrë koncize të gjitha çështjet e mosmarrëveshjeve. Përsëri, është një ndihmesë që efekti financiar mbi pasqyrat financiare përcaktohet aty ku duhet dhe është praktik.

15. **Mohimi i Opinionit.** Aty ku Auditori nuk mund të jep opinion në lidhje me pasqyrat financiare, të marrë si tërësi për shkak të paqartësisë apo restriksionit të fushëveprimit që është thelbësor që një opinion që është i kualifikuar në aspekte të caktuara nuk do të jetë adekuat, jepet opinion i kundërt. Formulimi i një opinionin të tillë e bënë të qartë që një opinion nuk mund të jepet, duke specifikuar në mënyrë të qartë dhe koncize të gjitha çështjet e paqarta.

16. Është bërë zakon që ISA të ofrojnë një raport të detajuar për të plotësuar opinion në rrethana në të cilat është e pamundur të jepet një opinion jo i kualifikuar.

Shtojca II: Rekomandimet e vitit paraprak

Komponenta e Auditimit	Rekomandimet e dhëna	Rekomandimet plotësisht të adresuara	Rekomandimet pjesërisht të adresuara	Rekomandimet e pa adresuara
4. Rezultati financiar në krahasim me buxhetin e aprovuar	Forcimin e kontrolleve financiare mbi menaxhimin e buxhetit, në veçanti të harmonizoj planin e rrjedhës së parasë me dinamikën e aktiviteteve operative (projekteve kapitale, furnizimet me mallra dhe shërbime) dhe të shqyrtoj në baza të rregullta ndryshimet në zërat buxhetor, duke analizuar të gjitha shmangiet nga objektivat e planifikuara.	Po		
6.1 Të hyrat	Të mos lidhë kontratë me borxhlinjtë të cilët kanë borxhe ndaj Komunës; Të rrisë kontrollet e inspektimit për të gjithë bizneset të cilët nuk i përgjigjen pagesave të borxhit, të ndërmerren masat ndëshkuese për të gjithë bizneset që kundërshtojnë			Jo

	<p>pagesën e tarifave mbi ngarkesa komunale; të siguroj se regjistrimi i të gjitha të hyrave do të bëhet sipas kodeve përkatëse; dhe të azhurnoj të gjithë regjistrat e obliguesve (bizneseve dhe personave fizik) të taksave komunale sipas të gjitha bazave të ngarkesës, t'i pasuroj regjistrat me të dhënat e duhura dhe të forcoj kontrollet e inkasimit sipas periudhave kohor.</p>			
6.2 Shpenzimet	<p>Procedurat e prokurimit të fillohen me kohë dhe në pajtim me kërkesat ligjore, dhe jo së pari të kryhen punët apo furnizimet, e pastaj të zhvillohen procedurat formale, Gjithashtu, asnjë kontratë të mos bëhet me operatorët që nuk përmbushin kriteret ligjore; të gjitha pagesat të bëhen në pajtim me kërkesat e kontratës dhe vetëm pasi të jenë bërë verifikimet e duhura se mallrat shërbimet e kontraktuara janë pranuar në sasinë dhe cilësinë e duhur; të</p>		Pjesërisht	

	<p>gjitha projektet e filluara kanë fonde të mjaftueshme financiare për t'u përfunduar; se për të gjitha vonesat në realizimin e projekteve të aplikoj penale sipas kontratës; të bëhet një ndarje më e qartë e detyrave për t'u shmangur konflikti i interesit.</p>			
6.2.2Kompenzi met	<p>Regjistër elektronik të dosjeve të nëpunëseve civil me të dhëna të nevojshme në pajtim me Rregulloren Nr.03/2011;</p> <p>Se dosjet e zyrtarëve janë azhurnuar me të gjitha të dhënat e duhura, se vlerësimi i punëtorëve kryhet në baza të rregullta, përshkrimi i punëve dhe formulari i pushimeve vjetore të sistemohen në dosjen personale të zyrtarëve; dhe</p> <p>Se çdo i punësuar posedon kontratë pune, në të cilën përcaktohet paga bazë. Në të kundërtën do të hiqet nga lista e pagave.</p>		Pjesërisht	

6.2.3 Subvencionet dhe Transferet	Miratimin e rregullores së brendshme që do të përcaktonte kriteret dhe procedurat e qarta gjatë ndarjes së subvencioneve dhe transfereve; dhe Se çdo përfitues të jetë i kompletuar me dokumentacion dhe të raportoj në departamentet përkatëse të Komunës mbi shpenzimet e mjeteve sipas kërkesës dhe projekteve të ofruara.			Jo
6.3 Pasuritë	Të përfundoj një regjistër gjithë përfshirës të pronës, objekteve dhe pajisjeve si dhe të njëjtat të regjistroj dhe të shpalos në pasqyrat financiare të vitit vijues; dhe të kryejë numërimin e rregullt fizik për tu siguruar mbi ekzistencën dhe të barazojë rezultatet e numërimit me të dhënat në kontabilitet dhe regjistrin të pasurisë.			Jo
7.1 Sistemi i kontrollit të	Rishikimin e sistemit aktual të kontrollit të brendshëm dhe aty		Pjesërisht	

brendshëm	ku janë identifikuar dështimet, të nxirren politika dhe procedura specifike me qëllim përmirësimi të kontrolleve.			
7.2 Auditimi i brendëshëm	Se funksioni i auditimit të brendshëm do të fuqizohet, Komitetit i auditimit do të jetë më aktiv dhe rekomandimet e auditimit do të zbatohen; dhe se auditimi i brendshëm do të ndjekë më tepër proceset e vitit aktual dhe jo ato të viteve të kaluara si dhe do të fokusohet në fushat me rrezik të lartë, siç janë të hyrat, prokurimi dhe pasuritë.	Po		
8. Një konkluzion i përgjithshëm mbi menaxhmentin e Prizrenit	Tërë stafi i komunës së bashku me menaxherët e kuptojnë relevancën e ligjeve që ndërlidhen me kornizën e KBFP dhe një numër dokumentesh të detyrueshëm të politikave, rregulloreve dhe doracakëve të Thesarit, doracakut të procedurave të MFK dhe një sërë udhëzimesh administrative qeveritare.			Jo

